



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE**  
**SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË**

# **RAPORTI VJETOR I ZHVILLIMIT TË PROCESIT TË AKREDITIMIT NË IOAFP**

**Tiranë 2024**

Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është person juridik publik përgjegjës për garantimin dhe sigurimin e cilësisë në Institucionet Ofruese të Arsimit Formimit Profesional, duke përdorur mekanizmat dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht cilësinë e institucioneve. AKAFPK mbështet IoAFP-të përgjatë rrugëtimit të tyre në zhvillimin e cilësisë.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit, si dhe në funksion të analizës së ecurisë së procesit të akreditimit, AKAFPK-ja harton raportin<sup>1</sup> e përvitshëm analitik në të cilin paraqet në mënyrë të përmblodhur veprimtaritë dhe ecurinë e IoAFP-ve në lidhje me procesin e akreditimit.

#### **AKAFPK**

**Adresa:**

*Rruga: "Mustafa Lleshi", Godina e Thesarit, kati i tretë, Tiranë, Shqipëri*

**Kontakt:**

*Tel/fax. +355 42237087*

**E-Mail:** [info.akafp@akafp.gov.al](mailto:info.akafp@akafp.gov.al)

**website:** [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al)

---

<sup>1</sup> Ky raport është dokument zyrtar i AKAFPK-së dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë AKAFPK.

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                  |    |    |
|----------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| SHKURTIMET .....                                                                 | 4  |    |
| PËRKUFIZIME.....                                                                 | 5  |    |
| PËRMBLEDHJE E RAPORTIT.....                                                      | 7  |    |
| <b>KAPITULLI I</b>                                                               |    |    |
| SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE FUNKSIONIMI I TYRE                |    |    |
| 1.1. HYRJE.....                                                                  | 8  |    |
| 1.2 AKAFPK: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....                     | 8  |    |
| 1.3 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË AKAFPK.....                    | 9  |    |
| 1.4 VLERËSUESIT E JASHTËM.....                                                   | 9  |    |
| <b>KAPITULLI II</b>                                                              |    |    |
| VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKAFPK.....                                             |    | 10 |
| 2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT.....       | 10 |    |
| 2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL.....         | 10 |    |
| 2.3 AKTIVITETI FINANCIAR.....                                                    | 13 |    |
| <b>KAPITULLI III</b>                                                             |    |    |
| SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE            |    |    |
| 3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE.....                                      | 16 |    |
| 3.2 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT.....                                 | 17 |    |
| 3.3 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE..            | 18 |    |
| <b>KAPITULLI IV</b>                                                              |    |    |
| BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË..... |    | 18 |
| <b>KAPITULLI V</b>                                                               |    |    |
| PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2025.....                                         |    | 19 |

## Shkurtime

|         |                                                                                |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------|
| AFP     | Arsim dhe formim profesional                                                   |
| AFPF    | Arsimi dhe formimi profesional fillestar                                       |
| AFPV    | Arsimi dhe formimi profesional i vazhduar                                      |
| AKAFPK  | Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve           |
| AKPA    | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive                                    |
| BE      | Bashkimi Evropian                                                              |
| CEDEFOP | Qendra Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional                         |
| ESG     | Standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë |
| ETF     | Fondacioni Evropian i Trajnimit                                                |
| GVJ     | Grupi i vlerësimit të jashtëm                                                  |
| ISO     | Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit                                      |
| KEK     | Korniza Evropiane e Kualifikimeve                                              |
| KSHK    | Korniza Shqiptare e Kualifikimeve                                              |
| MFE     | Ministria e Financave dhe Ekonomisë                                            |
| SC      | Sigurimi i cilësisë                                                            |
| SD4E    | Programi i UNDP në Shqipëri “Zhvillimi i Aftësive për Punësim”                 |
| UNDP    | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                                   |

## PËRKUFIZIME

**“Akreditimi”** është procesi i sigurimit të cilësisë, nëpërmjet të cilit një ofruesi të AFP-së i jepet statusi “i akredituar” nga autoritetet përkatëse ligjore dhe profesionale pas përmbushjes së standardeve të paracaktuara.

**“Ankimimi”** është procedurë standarde për të shprehur pakënaqësinë e institucionit, që ka paraqitur kërkesën për akreditim, lidhur me një masë të marrë nga institucionet përgjegjëse për procedurat e akreditimit.

**“Burimet e evidencave”** janë informacione (dokumente, raporte, statistika), informacione të marra nga vëzhgimet gjatë vizitës në terren, të cilat i shërbejnë verifikimit të plotësisë të kriterëve.

**“Cikli i cilësisë”** PZKV, planifiko – zbato – kontrollo – vepro.

**“Fusha e cilësisë”** është një dimension themelor i veprimtarisë së ofruesit të AFP-së. Përcaktimi i fushave të cilësisë së veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të AFP-së.

**“Nënfusha”**, çdo fushë e cilësisë ndahet në disa nënfusha, të cilat përshkruajnë elementet më të rëndësishme të një fushe të cilësisë, të cilat vlerësohen.

**“Koordinator i procesit të akreditimit”** është specialisti i AKAFPK-së, i cili përgjigjet për koordinimin dhe monitorimin e procedurës së akreditimit të një ofruesi të AFP-së, nga dorëzimi i kërkesës për akreditim deri në dhënien e vendimit të akreditimit.

**“Llogaridhënie”** është detyrimi i ofruesit të AFP-së, për të dëshmuar se një veprimtari është kryer në përputhje me rregullat dhe standardet apo për të raportuar në mënyrë transparente dhe të saktë për rezultatet e performancës, në përputhje me rolet dhe/ose planet e përcaktuara.

**“Standardet e cilësisë”** janë specifikimet teknike të cilat janë të matshme, që janë hartuar me dakordësi dhe janë miratuar nga një organizatë e njohur në nivele kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Qëllimi i standardeve të cilësisë është optimizimi i proceseve dhe/ose produkteve të të nxënit.

**“Treguesi”** është një fjali e matshme, pohuese, që tregon si është dhe si duhet të jetë niveli i fushave. Karakteristika të treguesit janë: a) hartohet për secilën nënfushë dhe mund të jenë një apo disa; b) është gjithnjë i matshëm, që do të thotë se lehtëson procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm; c) paraqet pohime që cilësojnë fushën/nënfushën që do të vlerësohet.

**“Kriteri”** është përshkruar i treguesit, i cili shprehet në formën e një fjalie që përcakton si zbatohet, si zhvillohet apo në ç’gjendje paraqitet treguesi i synuar. Kriteret janë kërkesat e cilësisë për akreditim.

**“Vetëvlerësimi”** është një proces i brendshëm, i cili kryhet nga çdo ofrues i AFP-së, nën përgjegjësinë e tij, për të vlerësuar performancën e institucionit lidhur me dy dimensione: a) dimensionin e brendshëm, i cili përfshin proceset e mësimdhënies/mësimxënies (shërbimet), personelin, politikat dhe organizimin e brendshëm; b) dimensionin e jashtëm, i cili mbulon analizën e ofertës arsimore të këtij institucioni, krahasuar me të tjerët: marrëdhënia me sistemin territorial të aktorëve (vendimmarrësit në nivel vendor, sindikatat, qeverisja vendore, lloji i tregut të punës dhe nevojat e AFP-së, rrjeti i informacionit, llojet e popullatave të interesuara në një ofertë mësimore dhe evoluimi i nevojave, rezultatet kryesore të punës në nivele kombëtare dhe evropiane në sektorin e AFP-së).

## **PËRMBLEDHJE E RAPORTIT**

Viti 2024 shënon vitin e tretë të zbatimit të procesit të akreditimit për institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri, duke vijuar një reformë të rëndësishme në këtë sektor. Ky proces synon garantimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, rritjen e standardeve të institucioneve dhe përputhjen e tyre me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

### **1. Institucionet e Përfshira dhe Progresi i Akreditimit**

Gjatë vitit 2024, aplikuan për nisjen e procesit të akreditimit katër institucione të Arsimit dhe Formimit Profesional. Procesi përfshiu disa faza kryesore, duke filluar nga dorëzimi i dosjes së aplikimeve, vlerësimi i dokumentacionit, vizitat në terren nga Grupi i vlerësuesve të jashtëm dhe hartimi i raportit përfundimtar.

### **2. Sfidat dhe Angazhimi në Procesin e Akreditimit**

Procesi i akreditimit u karakterizua nga sfida të shumta për institucionet aplikante dhe aktorët e përfshirë. Ofruesit e AFP-së u përballën me kërkesat për përmbushjen e standardeve të cilësisë, sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe përshtatjen me rregulloret në fuqi. Gjithashtu, procesi kërkoi angazhim të lartë nga stafet institucionale për të plotësuar kriteret e kërkuara.

### **3. Rezultatet dhe Përfundimet Kryesore**

Pavarësisht sfidave, viti 2024 solli një progres të rëndësishëm në akreditimin e institucioneve AFP. Përmes një pune intensive dhe përkushtimi të aktorëve të përfshirë, u arrit realizimi me sukses i procesit të akreditimit për institucionet që aplikuan. Ky rezultat dëshmon për rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe rëndësinë e këtij procesi për sigurimin e cilësisë në arsimin dhe formimin profesional.

Në përfundim, viti 2024 shënoi një hap të rëndësishëm në garantimin e cilësisë dhe standardizimin e kualifikimeve profesionale në Shqipëri, duke ndihmuar në zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të sektorit të Arsimit dhe Formimit Profesional.

**AKAFPK**

## KAPITULLI I

### SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN PROFESIONAL

#### 1.1. HYRJE

Hartimi dhe publikimi i "**Raportit Vjetor të Akreditimit 2024**" nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) përfaqëson një proces të rëndësishëm në kuadër të garantimit të cilësisë dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe rregullatore. Ky raport përmbledh në mënyrë analitike veprimtarinë e Sektorit të Akreditimit të Ofruesve të AFP-së, në AKAFPK gjatë vitit 2024, duke pasqyruar zhvillimet kryesore në fushën e akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP), sfidat e hasura dhe prioritetet strategjike për të ardhmen.

Dokumenti synon të ofrojë një panoramë të qartë mbi përparimet e arritura në përmirësimin e standardeve të akreditimit, proceset e vlerësimit të cilësisë dhe masat e marra për të siguruar një ofertë arsimore në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me standardet evropiane. Përmes analizës së të dhënave dhe përvojave të vitit 2024, raporti identifikon fushat që kërkojnë ndërhyrje dhe përshtatje për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm dhe rritje të cilësisë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

Në këtë kontekst, AKAFPK mbetet e angazhuar në forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e mekanizmave të vlerësimit, me qëllim garantimin e një sistemi akreditimi që mbështet institucionet arsimore në ofrimin e kualifikimeve profesionale të orientuara drejt kërkesave të tregut dhe zhvillimeve socio-ekonomike.

#### 1.2 AKAFPK: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

**AKAFPK-ja** është person juridik publik, buxhetor përgjegjës për ndjekjen, garantimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e formimin profesional. AKAFPK-ja, përmes mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e institucioneve të arsimit të formimit profesional në rang kombëtar.

AKAFPK-ja është krijuar për herë të parë me Vendim nr. 273, datë 10.5.2006, "*Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional*" dhe më pas Vendim nr. 321, datë 21.04.2011 si Agjenci Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve. Me Vendim nr. 673, datë 16.10.2019 u krye ristrukturimi i organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

**Misioni** i Agjencisë është sigurimi dhe krijimi i një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar bazuar në zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), siguron dhe garanton cilësinë e Listës Kombëtare të Profesioneve dhe Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, standardeve të profesioneve dhe të

kualifikimeve profesionale për nivelet 2-5 të KSHK-së, zbatimit të standardeve të programeve kombëtare, zhvillimit të standardeve të trajnimit të vazhduar të mësimdhënësve, specialistë të AFP-së, procesit të vlerësimit të cilësisë, si dhe të akreditimit të ofruesve të AFP-së.

**Vizioni** i Agjencisë është krijimi i një sistemi të integruar dhe fleksibël të kualifikimeve profesionale në përputhje me ndryshimet ekonomike dhe sociale, me nevojat e tregut të punës, i cili mundëson zhvillimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore.

Në veprimtarinë për përmbushjen e misionit të saj, Agjencia gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

### 1.3 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË AKAFPK

Struktura organike e Agjencisë në vitin 2025 është në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 155, datë 24.11.2020 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve"*. Agjencia është organizuar në dy drejtori dhe tre sektorë dhe numri i punonjësve aktualë është 25. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së, Sektori i Akreditimit të Ofruesve AFP-së, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve.

#### **Baza ligjore e funksionimit të AKAFPK**

Procesi i akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri ka filluar në vitin 2022 dhe tashmë ka hyrë në vitin e tretë të tij.

Në kuadër të këtij procesi, janë miratuar dhe zbatohen një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e AKAFPK-së. Këto dokumente ligjore përcaktojnë kornizën institucionale, kriteret e akreditimit, procedurat e vlerësimit dhe monitorimit, si dhe detyrimet e ofruesve të AFP-së për të garantuar cilësi në shërbimet e tyre.

Më poshtë gjendet një listë e ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë proces:

- Ligji nr. 15/2017, datë 16.02.2017, i ndryshuar "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" (i ndryshuar)
- Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Para universitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr. 673 datë 16.10.2019 "Për Organizimin Dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare Të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve".
- Urdhëri nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe

Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”.

- Rregullorja e brendshme miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me nr. 24/1 prot., datë 17.02.2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”.
- Urdhëri i brendshëm i AKAFPK-së me nr. 23, datë 12.05.2023 “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm, si dhe procedurat e brendshme në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”.

#### 1.4 VLERËSUESIT E JASHTËM

Në kuadër të vlerësimit të jashtëm të procesit të akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP), Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) angazhon ekspertë të jashtëm për të siguruar një proces objektiv dhe të besueshëm vlerësimi. Këta vlerësues të jashtëm përzgjidhen bazuar në kualifikimet e tyre profesionale, përvojën në fushat përkatëse dhe aftësinë për të ofruar një gjykim të pavarur, të drejtë dhe pa ndikime të jashtme, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

Gjatë viteve 2021 dhe 2022, AKAFPK ka ndërmarrë një proces përditësimi dhe zgjerimi të listës së vlerësuesve të jashtëm, duke synuar përfshirjen e ekspertëve me kompetenca të larta në fusha të ndryshme profesionale. Ky proces është bazuar në një vlerësim të kujdesshëm të kriterëve të përzgjedhjes, duke siguruar që vlerësuesit e angazhuar të përmbushin standardet e kërkuara për akreditimin e IoAFP-ve.

Si rezultat, deri në vitin 2024, AKAFPK disponon një databazë të zgjeruar me 48 vlerësues të jashtëm nga fusha të ndryshme, të cilët angazhohen në mënyrë fleksibile, sipas nevojave të zhvillimit të procesit të akreditimit. Ky sistem i përzgjedhjes dhe angazhimit siguron një proces vlerësimi transparent, të paanshëm dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e akreditimit të arsimit dhe formimit profesional.

## KAPITULLI II

### VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKAFPK

#### 2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT

AKAFPK, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me paketën ligjore të arsimit dhe formimit profesional si dhe Urdhërit nr. 128/2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, përgatit dhe përmirëson vazhdimisht, dokumentat dhe formatet e nevojshme për sigurimin e cilësisë.

## 2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Edhe gjatë vitit 2024, akreditimi i institucioneve të arsimit të formimit profesional u mbështet te Urdhëri nr. 128 datë 6.7.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për miratimin e “Rregullores për standardet, kriteret dhe Procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional”.

Bazuar në Urdhërin nr. 128 datë 6.7.2021 të MFE, procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

### ***Faza përpara vizitës në terren***

- a) hapi i parë: ofruesi i AFP-së dorëzon kërkesën për akreditim dhe dokumentet e nevojshme;
- b) hapi i dytë: AKAFPK-ja shqyrton dokumentacionin;
- c) hapi i tretë: AKAFPK-ja ngre grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) dhe përgatit vizitën në terren.

***Në vitin 2024, në AKAFPK kanë aplikuar për akreditim:***

#### ***- 4 IoAFP publike***

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në dokumentacionin fillestar:

**Hapi i parë:** ofruesi i AFP-së dorëzon kërkesën zyrtare për vlerësim të jashtëm për akreditim, e cila përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e ofruesit të AFP-së;
- b) qëllimin e kërkesës;
- c) adresën dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit të AFP-së, përfshirë faqen e internetit (nëse ka);
- d) të dhënat e statusit ligjor dhe tatimor të ofruesit të AFP-së;
- e) përfaqësuesin ligjor dhe personin përgjegjës (personin e kontaktit);
- f) të gjitha kualifikimet profesionale të akredituara ose jo, të cilat çojnë ose nuk çojnë në kualifikime sipas KSHK-së;
- g) listën e dokumenteve shoqëruese.

**Hapi i dytë:** Kërkesa për akreditim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- a) dokument i themelimit/licenca si ofrues jopublik i AFP-së;
- b) përshkrim i shkurtër i institucionit: objekti i aktivitetit, rezultatet kryesore, kredencialet, përshkrim të përgjithshëm të personelit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe të burimeve;
- c) argumentim mbi domosdoshmërinë e ofrimit të kualifikimit/kualifikimeve profesional/e, për të cilin akreditohet;
- d) organigramë e institucionit;
- e) rregullore e brendshme e institucionit;
- f) dokument pronësie për kohën e akreditimit;
- g) vendim për ngritjen e ekipit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- h) plan për zbatimin e proceseve të sigurimit të cilësisë;
- i) raport i vitit të fundit të vetëvlerësimit për pesë fushat e cilësisë, sipas formatit në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje. Përgjashtim bëjnë ofruesit e rinj të AFP-së;
- j) në fazën e vizitës në terren, ofruesi duhet të ketë të dhëna të plota (për pesë fushat e cilësisë,

sipas formatit në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje), për periudhën nga raporti final i vetëvlerësimit, deri në datën e vizitës;

k) plan afatmesëm aktual i miratuar;

l) plan vjetor aktual i miratuar;

m) standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve, si dhe dokumentet kurrikulare për kualifikimet profesionale, për të cilat kërkon akreditim;

n) listë e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës, për kualifikimet profesionale, për të cilat aplikon për akreditim, së bashku me kualifikimet dhe përvojën e tyre;

o) CV-të e personelit drejtues, mësimdhënës dhe mbështetës sipas formatit Europass;

p) kontratat e vlefshme të punës për periudhën, për të cilën do të akreditohet;

q) plani financiar për periudhën e akreditimit (katër vite);

r) listat e klasave, laboratorëve, mjediseve të praktikës profesionale, pajisjeve, teksteve shkollore, materialeve ndihmëse për mësimdhënien, etj., për kualifikimet profesionale për të cilat aplikon për akreditim;

s) marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkruara me punëdhënësit apo sektorin e biznesit, për të nxënëit me bazë punën, nëse ka;

t) autorizimet e shëndetit publik dhe certifikatat e sigurisë nga zjarri.

**Në aplikimet e shqyrtuara** për akreditim gjatë vitit 2024, është refuzuar vetëm një kërkesë akreditimi me argumentet përkatëse pasi dokumentacioni plotësues nuk u dërgua nga ofruesi edhe pas njoftimit duke respektuar afatet ligjore.

### **Llojet e akreditimit**

Akreditimi i ofruesve të AFP-së mund të jetë:

a) *akreditim i plotë* i ofruesve ekzistues të AFP-së, kur bazohet në vlerësimin e plotë të të gjitha kriterëve bazë dhe kriterëve plotësues;

b) *akreditim me kusht*, që i jepet një ofruesi i cili vlerësohet se i ka plotësuar të gjitha kriteret bazë, por nuk ka përmbushur të gjitha kriteret plotësues. Mosplotësimi qoftë vetëm i një kriteri plotësues, ka si rezultat akreditimin me kusht;

c) *mosakreditim* i ofruesve të AFP-së, është nëse ofruesi nuk përmbush qoftë edhe vetëm një kriter bazë

d) *riakreditim* i ofruesve ekzistues të AFP-së, që bëhet çdo 4 vite pas marrjes së akreditimit të plotë dhe bazohet në vlerësimin e plotë të të gjitha kriterëve bazë dhe kriterëve plotësues;

### **Faza e vlerësimit të jashtëm**

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, procesi kalon në fazën e vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i jashtëm, bazohet në analizën, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vlerësimin përmes vizitës në terren në institucionin aplikues. Grupet e vlerësimit të jashtëm, kanë vlerësuar dhe dakordësuar gjykimet për të gjitha institucionet dhe kualifikimet profesionale të vlerësuar. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni fillestar ka vijuar me vizitën në institucion dhe

hartimin e raportit përfundimtar. Grupet e vlerësimit të jashtëm kanë kryer vizita 3 ditore në IoAFP-në përkatëse për çdo proces. Aktivitetet janë zhvilluar sipas agjendave të dakordësuara mes palëve dhe dërguar paraprakisht IoAFP-ve.

Në përfundim, vlerësuesit e jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit të jashtëm të cilat u janë dërguar AKAFPK-së, e cila më pas ka validuar raportin dhe ia ka dërguar institucionit që ka aplikuar për komente apo sqarime. Proceset janë përmbyllur me hartimin e raportit përfundimtar i cili, përveç pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “rekomandimet” e mëtejshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Mbështetur në rezultatet e vlerësimit të jashtëm në kuadër të procesit të akreditimit institucional, përkundrejt standardeve, vlerësuesit e jashtëm japin gjykimet e tyre në lidhje me fushat, nënfushat, treguesit dhe vlerësojnë shkallën e përmbushjes të standardeve të cilësisë sipas kategorive:

- *Nuk përmbushen*
- *Përmbushen*

Gjatë vitit 2024, në AKAFPK janë përfunduar **3 procedura akreditimi**, nga të cilat:

- **2 IoAFP kanë marrë akreditim me kusht**
- **1 IoAFP ka marrë akreditim të plotë.**

Gjatë vitit 2024 AKAFPK ka realizuar trajnime si vijon:

- **1 trajnim i vazhduar profesional** për Vlerësuesit e Jashtëm të certifikuar në kuadër të procesit të akreditimit të IoAFP-ve;
- **30 vlerësues të jashtëm** të trajnuar dhe të certifikuar në këtë proces trajnimi

## 2.3 AKTIVITETI FINANCIAR

Procesi i akreditimit të ofruesve të AFP-së mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

1. Vendim Nr. 673, datë 16.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” (lidhja 1 dhe 2)

2. Urdhër Nr. 128, datë 6.7.2021 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”.

3. Urdhrit nr. 21, datë 13.4.2023 me nr. 113/1 prot., datë 13.4.2023 “Për miratimin e Udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes dhe shpërblimit të specialistëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve në projekte me kontratë për realizimin e veprimtarive zhvillimore të AKAFPK”.

4. Urdhër nr. 23, datë 12.5.2023, protokolluar me nr. 201, datë 12.5.2023, “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm si dhe procedurat e brendshme në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”.

AKAFPK i realizon veprimtaritë e saj nëpërmjet financimeve nga buxheti i shtetit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër. Këto financime përdorën për pagesat e

vlerësuesve të jashtëm, të cilat janë të kontraktuar në AKAFPK, si dhe për të mbuluar nevojat materiale për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

Në këtë kapitull janë trajtuar kostot financiare për proceset e akreditimit dhe të monitorimit të ofruesve të AFP-së, për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 janë kryer pagesat sipas kuadrit ligjor të sipërcituar për ofruesit:

| <b>PROCESI I AKREDITIMIT PËR VITIN 2024</b>             |                                       |                                           |                   |                                 |                    |
|---------------------------------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------|---------------------------------|--------------------|
| <b>Ofruesit</b>                                         | <b>Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm</b> | <b>Numri i kualifikimeve profesionale</b> | <b>Orët total</b> | <b>Pagesa për orë pune/lekë</b> | <b>Totali/lekë</b> |
| Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka", Lezhë       | 3 anëtarë                             | 15                                        | 352               | 1050/750                        | 300.96             |
| Shkolla e Mesme Industriale "Petro Sota", Fier          | 3 anëtarë                             | 17                                        | 352               | 1050                            | 369,600            |
| Shkolla e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli", Berat | 3 anëtarë                             | 15                                        | 352               | 1050                            | 369.6              |
| Shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër    | N/A                                   | 12                                        | N/A               | N/A                             | N/A                |

| <b>MONITORIMI I POSAÇËM 2024</b>                                      |                   |                                 |                    |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------|--------------------|
| <b>Ofruesit</b>                                                       | <b>Orët total</b> | <b>Pagesa për orë pune/lekë</b> | <b>Totali/lekë</b> |
| Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Erickson", Golem-Kavajë | 40.8              | 1050                            | 42.84              |
| Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës                     | 50.25             | 1050                            | 52.762             |

Më poshtë jepet lista e plotë e kualifikimeve profesionale për të cilat ka aplikuar secili prej ofruesve:

**1) Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë për kualifikimet profesionale si më poshtë:**

1. “Hoteleri-turizëm”, Niveli II i KSHK-së, G-II-22
2. “Kuzhinë-pastiçeri”, Niveli III i KSHK-së, G2-III-22
3. “Shërbime udhëtimi dhe turizmi”, Niveli IV i KSHK-së, G6-IV-18
4. “Hoteleri-turizëm”, Niveli IV i KSHK-së, G-IV-20
5. “Teknologji Ushqimore”, Niveli II i KSHK-së , A-II-21
6. “Teknologji e përpunimit të brumit”, Niveli III i KSHK-së, A1-III-22
7. “Teknologji Ushqimore”, Niveli IV i KSHK-së ,A-IV-23
8. “Ekonomi Biznes”, Niveli II i KSHK-së , L-II-21
9. “Tregti”, Niveli IV i KSHK-së, L6-IV-23
10. “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, Niveli II i KSHK-së ,T-II-19
11. “Zhvillim Website”, Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21
12. “Multimedia”, Niveli IV i KSHK-së , T5-IV-21
13. “Shërbime Sociale dhe Shëndetsore”, Niveli II i KSHK-së, O-II-22
14. “Shërbimi Kujdesi për fëmijë”, Niveli III i KSHK-së, O2-III-20
15. “Shërbime Sociale dhe Shëndetsore”, Niveli IV i KSHK-së, O-IV-21

**2) Shkolla e Mesme Industriale “Petro Sota”, Fier për kualifikimet profesionale si më poshtë:**

1. “Elektroteknikë” Niveli II i KSHK-së, E-II-21
2. “Instalime elektrike, civile dhe industriale” Niveli III i KSHK-së, E1-III-21
3. “Elektroteknikë” Niveli IV i KSHK-së, E-IV-21
4. “Mekanikë” Niveli II i KSHK-së, F-II-22
5. “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”, Niveli III i KSHK-së, F3-III-18
6. “Mekanikë” Niveli IV i KSHK-së, F-IV-19
7. “Shërbime mjetesesh transporti” Niveli II i KSHK-së, M-II-21
8. “Shërbime elektro-auto” Niveli III i KSHK-së, M3-III-22
9. “Shërbime mjetesesh transporti” Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23
10. “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” Niveli II i KSHK-së, T-II-19
11. “Zhvillim Website” Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21
12. “Termohidraulikë” Niveli II i KSHK-së, V-II-20
13. “Instalime hidraulike” Niveli III i KSHK-së, V1-III-22
14. “Termohidraulikë” Niveli IV i KSHK-së, V-IV-23
15. “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gazi dhe ujit” Niveli II i KSHK-së, X-II-20
16. “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit” Niveli III i KSHK-së, X1-III-23
17. “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gazi dhe ujit” Niveli IV i KSHK-së, X-IV-18

**3) Shkolla e Mesme Profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat për kualifikimet profesionale si më poshtë:**

1. “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK, M-II-21;
2. “Shërbime elektroauto”, Niveli III në KSHK, M3-III-22;
3. “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli IV në KSHK, M-IV-23;
4. “Diagnostikim dhe menaxhim në autoservis”, Niveli V në KSHK, M1-V-23
5. “Elektroteknikë”, Niveli II në KSHK, E-II-21;
6. “Instalim elektrik civil dhe industrial”, Niveli III në KSHK, E1-III-20;
7. “Elektroteknikë”, Niveli IV në KSHK, E-IV-21;
8. “Mekanikë”, Niveli II në KSHK, F-II-22;
9. “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”, Niveli III në KSHK, F3-III-18;
10. “Mekanikë”, Niveli IV në KSHK, F-IV-19;
11. “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, Niveli II në KSHK, T-II-19;
12. “Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut”, Niveli IV në KSHK, T2-IV-21;
13. “Termohidraulikë”, Niveli II në KSHK, V-II-20;
14. “Instalime të sistemeve ngrohëse – ftohëse”, Niveli III në KSHK, V2-III-22;
15. “Termohidraulikë”, Niveli IV në KSHK, V-IV-23.

**4) Shkolla e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër për kualifikimet profesionale si më poshtë:**

1. “Ekonomi Biznes”, Niveli II i KSHK-së , L-II-21
2. “Tregti”, Niveli IV i KSHK-së, L6-IV-23
3. “Llogari” Niveli IV i KSHK-së, L4-IV-23
4. “Hoteleri-turizëm”, Niveli II i KSHK-së, G-II-22
5. “Kuzhinë-pastiçeri”, Niveli III i KSHK-së, G2-III-22
6. “Bar restorant” Niveli III i KSHK-së, G1-III-18
7. “Shërbime në hotel dhe restorant”, Niveli III i KSHK-së, G5-III-18
8. “Shërbime udhëtimi dhe turizmi”, Niveli IV i KSHK-së, G6-IV-18
9. “Hoteleri-turizëm”, Niveli IV i KSHK-së, G-IV-20
10. “Tekstil konfeksione”, Niveli II i KSHK-së, D-II-17
11. “Modelim” Niveli III i KSHK-së, D3-III-19
12. “Tekstil Konfeksione” Niveli IV i KSHK-së, D-IV-19

### KAPITULLI III

## SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE

### 3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE


AKAFPK, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale, monitoron ecurinë e proceseve të ndryshme bazuar në mbledhjen dhe arkivimin e të dhënave. Bazuar në punën e bërë ndër vite, sistemi i menaxhimit të të dhënave fokusohet në:

- Menaxhim i procedurave të akreditimit institucional për kualifikime profesionale sipas niveleve të KSHK-së;
- Monitorim i ofruesve të akredituar të AFP-së;
- Menaxhim të komunikimeve elektronike e postare;
- Komunikim me institucionet, ekspertët dhe vlerësuesit e jashtëm;
- Plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve;

#### Statistika mbi dokumentat e arkivës

E gjithë korrespondenca midis AKAFPK dhe ofruesve të AFP-së, gjithashtu dhe institucioneve të tjera menaxhohet nga zyra e arkiv-protokollit të institucionit.

Në grafikun e mëposhtëm shfaqet shpërndarja e dokumentave sipas llojit, lidhur me procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së.



### 3.2 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

AKAFPK, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, ndër vite ka ndërtuar një sistem të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimin e publikut bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, AKAFPK ka miratuar programin e transparencës dhe e ka publikuar në faqen zyrtare. Ky program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e punës së AKAFPK, nëpërmjet pasqyritit në faqen zyrtare. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare. Në këtë program transparence AKAFPK ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik.

*Gjatë vitit 2024, kanë ardhur gjithësej 5 kërkesa për informacion në formë elektronike ose shkresore nga ofrues të ndryshëm në lidhje me procesin e akreditimit.*

Në kuadër të transparencës dhe informimit në kohë reale, faqja zyrtare e AKAFPK mundëson informacion për publikun dhe palët e interesuara në format të kuptueshëm. Faqja e AKAFPK publikon të dhënat në kohë reale duke garantuar për publikun dhe palët e interesuara informacion të përditësuar dhe të besueshëm. *Edhe gjatë vitit 2024, në faqen zyrtare të AKAFPK janë pasqyruar aktivitetet e saj si dhe vendimet për akreditimin e kualifikimeve profesionale të ofruesve të AFP-së.*

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga informacionet e të dhënat që i vihen në dispozicion publikut dhe palëve të interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të AKAFPK janë:

- Informacion për procesin e akreditimit me të dhëna për çdo proces të zhvilluar nga çdo ofrues AFP-je, publik dhe jo-publik;
- Raporte të akreditimit institucional të ofruesve të AFP-së për kualifikime profesionale sipas niveleve të KSHK-së;
- Vendime të Ministrisë përgjegjëse për AFP-në;
- Publikime të akteve/bazës ligjore mbi të cilat bazohet procesi akreditimit;
- Raporte vjetore, rregullore, udhëzues.

### 3.3 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit/ dokumentacionit në AKAFPK zbatohet nga zyra e arkiv/protokollit të institucionit. Çdo dokument ruhet në formë fizike dhe elektronike në arkivën dhe databazën e institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”. Në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, AKAFPK klasifikon informacionin sipas statusit të tij, publik, përdorim të brendshëm dhe

konfidencial. Po ashtu dhe aksesimi në dokumentacion për stafin e AKAFPK-së dhe Vlerësuesve të Jashtëm, bëhet në funksion të procesit/procedurës së cilës i përket dokumentacioni të miratuar me rregulloren e brendshme me nr. 24/1 prot, datë 17.2.2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Në funksion të proceseve të akreditimit dhe monitorimit së bashku me dosjen e printuar, në AKAFPK dorëzohen edhe dokumentat në versionin elektronik (nëse ka të tilla). Evidencat e procesit të akreditimit, të dërguara nga vetë ofruesi në AKAFPK si dhe nga vlerësuesit e jashtëm, në përfundim të procesit ato dorëzohen nga Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, në zyrën e arkiv-protokollit të AKAFPK-së, nëpërmjet një procesverballi të mbajtur midis palëve.

#### **KAPITULLI IV**

### **BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË**

AKAFPK në bashkëpunim me ERI SEE ka zhvilluar trajnimin e vazhduar profesional për vlerësuesit e jashtëm të procesit të akreditimit, si dhe ka shkëmbyer eksperiencë të ndryshme lidhur me praktikën e mira evropiane në kuadër të procesve të sigurimit të cilësisë në shkollë.

Në bashkëpunim me ERI SEE u zhvillua gjithashtu edhe validimi i politikave të mëparshme të të nxënies joformale dhe informale dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës në Ballkanin Perëndimor në datat 14-15 nëntor 2024 në Vlorë, Shqipëri. Workshopi u organizua në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve – AKAFPK, UNDP Shqipëri dhe Iniciativën për Reformën në Arsim të Evropës Juglindore – ERI SEE. Në këtë workshop u mbledhën përfaqësues të Agjencive të AFP-së, Agjencive të kualifikimeve profesionale dhe ministrave të arsimit nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor.

AKAFPK ka marrë pjesë gjithashtu edhe në webinarin e zhvilluar nga EQAVET me tematikë “Edukimi për sigurimin e cilësisë për qytetarinë demokratike në AFP, më datë 24-25 Prill 2024.

#### **KAPITULLI V**

### **PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2025**

Sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së në AKAFPK ka si funksione kryesore:

- a) Të vlerësojë cilësinë dhe të akreditojë ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së si dhe qendrat e vlerësimit për zbatimin e procedurave të njohjes të të nxënies të mëparshme joformale dhe informale.

- b) Të mbështesë metodologjikisht Njësitë e Zhvillimit të ofruesve të AFP-së;
- c) Të mbështesë ofruesit e AFP-së për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në përputhje me kriteret e akreditimit;
- d) Të hartojë dhe të rishikojë standardet dhe kriteret e akreditimit të qendrave për zhvillimin e procedurave të njohjes të të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal;

Referuar synimeve të mësipërme, gjatë vitit 2025, AKAFPK parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

#### **a) Vlerësimi i cilësisë nëpërmjet procesit të akreditimit të ofruesve të AFP-së**

Ky proces synon të sigurojë që institucionet që ofrojnë Arsim dhe Formim Profesional të përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Në këtë kuadër, AKAFPK do të:

- Hartojë dhe përmirësojë kriteret e akreditimit, duke përfshirë aspekte si programet mësimore, burimet njerëzore, infrastruktura dhe rezultatet e të nxëniet.
- Pranojë dhe shqyrtojë kërkesat e institucioneve që aplikojnë për akreditim, duke realizuar analiza dokumentacioni dhe vizita në terren.
- Organizojë trajnime për institucionet e interesuara për t'i ndihmuar në përmbushjen e standardeve të kërkuara.
- Publikojë raportet e akreditimit dhe rezultatet për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e sistemit të arsimit profesional.

#### **b) Mbështetja e veprimtarisë së Vlerësuesve të Jashtëm**

Vlerësuesit e Jashtëm luajnë një rol kyç në procesin e akreditimit dhe monitorimit të cilësisë. Për t'i mbështetur ata, AKAFPK do të:

- Organizojë trajnime dhe seminare për përditësimin e njohurive të tyre mbi standartet dhe metodologjitë e vlerësimit.
- Krijojë dhe pasurojë më tej një bazë të dhënash të ekspertëve dhe të garantojë që vlerësimi të bëhet në mënyrë të pavarur dhe objektive.
- Sigurojë mbështetje dhe mjetet e nevojshme për realizimin e vizitave në terren gjatë procesit të akreditimit dhe raportimit në mënyrë efikase.

#### **c) Përmirësimi i kushteve infrastrukturore për realizimin e veprimtarive në kuadër të procesit të akreditimit**

Ky objektivi synon të rrisë cilësinë dhe efikasitetin e procesit të akreditimit përmes:

- Modernizimit të hapësirave të punës, pajisjeve dhe teknologjisë për lehtësimin e proceseve vlerësuese.
- Digjitalizimit të procedurave të akreditimit për të reduktuar burokracinë dhe për të siguruar

akses më të shpejtë dhe më të lehtë për aplikantët.

- Sigurimit të infrastrukturës për organizimin e trajnimeve dhe workshop-eve për institucionet e AFP-së.

#### **d) Monitorimi i ofruesve të akredituar të AFP-së për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë**

Procesi i monitorimit ka për qëllim të sigurojë që institucionet e akredituara të ruajnë standardet e vendosura. AKAFPK do të:

- Kryejë vizita të rregullta monitorimi për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, përdorimin e burimeve dhe pajisjeve, në zbatim të Urdhrit nr. 128, datë 6.7.2021, të MFE-së, Neni 23, “Monitorimi i ofruesve të akredituar të AFP-së”, Pika 1., ku citohet “Procesi i monitorimit të ofruesve të akredituar të AFP-së ka si qëllim të vlerësojë (verifikojë) përputhshmërinë me standardet dhe kriteret e akreditimit, në vijimësi, nga ofruesit e akredituar të AFP-së”.
- Hartojë raporte vlerësimi për secilin institucion dhe të sugjerojë masa për përmirësim aty ku është e nevojshme.
- Krijojë mekanizma për të mbledhur dhe analizuar reagimet e studentëve, mësuesve dhe punëdhënësve lidhur me cilësinë e arsimit profesional në Shqipëri.
- Bashkëpunojë me institucionet e AFP-së për hartimin e planeve të përmirësimit të vazhdueshëm.

#### **e) Aktivitete në bashkëpunim me aktorë të tjerë në fushën e arsimit profesional**

Bashkëpunimi ndërinstitucional është thelbësor për zhvillimin e arsimit profesional në Shqipëri. Në këtë drejtim, AKAFPK do të:

- Organizojë tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca me përfaqësues të ministrive, institucioneve arsimore dhe sektorit privat për të diskutuar sfidat dhe mundësitë në AFP.
- Zhvillojë projekte të përbashkëta me organizata ndërkombëtare dhe vendase për të mbështetur zhvillimin e politikave arsimore.

#### **f) Përmirësimi i kushteve infrastrukturore për realizimin e veprimtarive në kuadër të procesit të akreditimit**

Në vijim të përpjekjeve për konsolidimin dhe rritjen e cilësisë së procesit të akreditimit, AKAFPK do të:

- Investojë në zhvillimin e platformave digjitale për vlerësim dhe monitorim në kohë reale të ofruesve të AFP-së.
- Pajisë zyrat dhe hapësirat e punës me teknologji të re për të lehtësuar komunikimin dhe analizën e të dhënave.
- Sigurojë burime financiare për modernizimin e sistemeve të raportimit dhe arkivimit të të dhënave të institucioneve të akredituara.